devPMS Sistem për menaxhimin e hoteleve dhe strukturave akomoduese

Ti që transferon me MoneyGram®... EJA DHE FITO!

Kronikë

# VIDEO/ Me arsenal armësh në mur, në hetim 67-vjeçari në Vlorë! Iu gjetën 2 kallashnikovë, 2200 fishekë e 12 granata

*Në murin e një ndërtese në Vlorë, uniformat blu gjetën dhe sekuestruan 2 armë zjarri automatike, mbi 2200 fishekë luftarak dhe 12 granata difensive.*

Redaksia
18 Qershor, 10:37 | **Përditesimi: 18 Qershor, 11:03**

f Share



**Vlorë**-Gjatë një aksioni për parandalimin dhe goditjen e veprimtarive të paligjshme, Policia e Vlorës ka zbuluar dhe sekuestruar një sasi të konsiderueshme armatimi dhe municioni luftarak, të fshehur në murin e një ndërtese të braktisur në lagjen "Hajro Çakërri".

Gjatë kontrollit të ushtruar në katin e dytë të ndërtesës, blutë zbuluan të murosura 2 armë zjarri automatike, 12 granata difensive pa ndezës, 14 ndezës granatash, dhe rreth 2200 fishekë luftarak.

Armët dhe municionet e sekuestruara do të dërgohen në Institutin e Policisë Shkencore për ekspertim, me qëllim verifikimin nëse janë përdorur në ngjarje kriminale.



LEXO EDHE:
**'Osmani' shijon bukuritë e jugut të Shqipërisë nga qielli, fluturimi me parashutë i aktorit Burak Özçivit mbi Vlorë (VIDEO)**

Pronari i banesës, 67-vjeç për shkak të gjendjes shëndetësore do të hetohet në gjendje të lirë.

**Njoftimi i policisë:**

*Shërbimet e Komisariatit të Policisë Vlorë, në vijim të kontrolleve për parandalimin dhe goditjen e veprimtarive të paligjshme, bazuar në informacionet e siguruara nga inteligjenca policore, kanë ushtruar kontroll në një ndërtesë të vjetër të pabanuar, në lagjen "Hajro Çakërri", Vlorë, në katin e dytë të së cilës gjetën të murosura disa armë dhe municion luftarak.*

*Në cilësinë e provës materiale u sekuestruan: 2 armë zjarri automatike, 12 granata difensive pa ndezës, 14 ndezës granatash të mbështjellë me letër dhe rreth 2200 fishekë luftarak.*

*Armët dhe municioni do të dërgohen në Institutin e Policisë Shkencore, për ekspertim të mëtejshëm, me qëllim përcaktimin nëse janë përdorur në ngjarje kriminale.*

*Nga verifikimet rezultoi se ndërtesa ku u gjetën armët dhe municioni është në pronësi të shtetasit Gj. K., 67 vjeç, banues në lagjen "Hajro Çakërri", i cili, në përfundim të veprimeve procedurale, është proceduar penalisht në gjendje të lirë, për shkak të moshës dhe të gjendjes shëndetësore.*

Materialet iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, për veprime të mëtejshme.

Xh.K/Shqiptarja.com

TAG: Vlore | arme zjarri | granate

**Komente**

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:** 22 Qershor, 09:47
**Si e vlerësoni sulmin e SHBA-së ndaj impianteve bërthamore të Iranit?**

Të drejtë | Të gabuar | Nuk e di

## Lajme të tjera



'Netët e Bejkës së Bardhë' në Pilur të Himarës, 18 grupe folklorike sjellin me mjeshtëri këngët labe
Armand Xhelili
22 Qershor, 14:09



Aksident në aksin Vlorë-Selenicë, 23-vjeçari në gjendje të rëndë! Transportohet te Trauma
22 Qershor, 13:29



Rikthehet furnizimi me ujë në Vlorë, Murati: Projekti i ri i ujësjellës, zgjidhje përfundimtare
Armand Xhelili
22 Qershor, 13:06



Rama prezanton skuadrën fituese të Vlorës për Shqipërinë 2030 në BE
22 Qershor, 12:42



Muzikë pas mesnate në Radhimë, pronari i lokalit gjobitet me 4 mln lekë
22 Qershor, 12:28



Himarë/ Riaktivizohet zjarri në kodrat e Pilurit, vijon ndërhyrja me helikopter! Vatër edhe në Kudhës, rrezikohet një banesë
22 Qershor, 11:08



Gara e qyteteve për turistët, Tirana më e lira, por më e zëna
22 Qershor, 10:30



Zjarr në Pilur të Himarës, flakët pranë ullishteve! Zjarrfikësit në terren, pritet ndërhyrje nga ajri (VIDEO)
21 Qershor, 19:02



Vëzhgimi i Report Tv/ Plazhet publike të Vlorës mes plehrave dhe betonit të Lungomares! Në Shëngjin kushte më të mira, por me pagesë
Armand Xhelili
Elvis Hila
21 Qershor, 14:47



Vidhte paratë e turistëve nëpër makina, arrestohet hajduti beratas në Sarandë (VIDEO)
21 Qershor, 14:29



Në fundjavë 'të gjithë' plazh në Vlorë, trafik i rënduar në qytet (VIDEO)
21 Qershor, 12:32



Pengojnë projektin e Lungomares, IKMT shemb e objektin në Radhimë në mes të sezonit! Tavolinat e lokaleve hiqen nga trotuaret e shëtitores në Vlorë (VIDEO)
21 Qershor, 10:27

Je në Aeroport?

devPMS Sistem për menaxhimin e hoteleve dhe strukturave akomoduese Mëso më shumë

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com



© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje